



Dalës: Izložba

Nr. -1-104

Data 31.08.2020

Br.

Datum

OBILIQ - OBILIC



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



**RREGULLORE PËR NDARJEN E BURSIVE,
KOMPENSIMIN E SHPENZIMEVE TË UDHËTIMIT
DHE AKTIVITETEVE JASHTËSHKOLLORE**

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 12.2, nën pikën (c), nenit 17 pika (s) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës), nr.28/2008, paragrafin 5 të nenit 15 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar nr.04L/032, paragrafin 1.3 të nenit 38, dhe nenin 81 të Statutit të Komunës së Obiliqit nr.-I-34 të dt.25/04/2016, Kuvendi i Komunës së Obiliqit, në mbledhjen e mbajtur më _____, miratoi:

RREGULLOREN PËR NDARJEN E BURSIVE, KOMPENSIMIN E SHPENZIMEVE TË UDHËTIMIT DHE AKTIVITETEVE JASHTËSHKOLLORE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Në këtë Rregullore, përcaktohen procedurat, kushtet, kriteret për ndarjen e bursave, kohëzgjatja e realizimit të bursës, për nxënës të shkollave të mesme të larta, studentët e të tri niveleve në studime akademike, në nivelin bachelor, në nivelin master dhe në nivelin e doktoratës, kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit për nxënës në relacionin shtëpi-shkollë dhe anasjelltas, dhe për aktiviteteve jashtëshkollore.

Neni 2

Ndarja e bursave

1. Komuna e Obiliqit, varësisht prej mjeteve financiare që ka në dispozicion, (në bazë të vitit aktual buxhetor – vitit fiskal) ndanë bursa për nxënës dhe studentë të Komunës së Obiliqit, që mësimet përkatësisht studimet i vijnë në bartësit publik të arsimit parauniversitar dhe universitar.

2. Për nivelet e studimeve master dhe të doktoratës bursat ndahen për studentët që studimet i vijnë në bartësit e sistemit publik të arsimit universitar edhe për studentët që vijnë studimet jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

Neni 3

Shuma financiare

1. Kryetari i Komunës në bazë të konkursit të shpallur nga DKA dhe në bazë të raportit të komisionit vlerësues me vendim, cakton shumën financiare për bursa, kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe aktiviteteve jashtëshkollore që ndahen për një vit shkollor, përkatësisht akademik.

2. Në bazë të mundësive financiare të planifikuar me buxhetin komunal (DKA) Kryetari i Komunës në konsultim me komisionin vlerësues, me vendim përcakton se në sa pjesë do të ndahen bursat përkatësisht shpenzimet e udhëtimit.

Neni 4

Kohëzgjatja e bursës

Bursa ndahet vetëm për vitin shkollor, përkatësisht akademik, për të cilin është publikuar konkursi.

Neni 5

Formimi i komisioneve

1. Komisioni, për ndarjen e bursave, kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe aktiviteteve jashtëshkollore, formohet nga Kryetari i Komunës, komisioni do t'i ketë tre (3) anëtar nga shërbyesit civil të Komunës së Obiliqit, me mandat një vjeçar për çdo vit fiskal.
2. Komisioni i ankesave për kandidatët e pakënaqur me vlerësimin e komisionit i cekur në pikën 1 të nenit 5 e formon Kryetari i Komunës, komisioni do t'i ketë tre (3) anëtar nga shërbyesit civil të Komunës së Obiliqit, si dhe do të ketë mandat një (1) vjeçar për çdo vit fiskal.

Neni 6

Shpallja e konkurseve

1. Konkursët shpallen nga Drejtoria e Arsimit (DA), në ueb-faqen zyrtare të Komunës dhe në tabelën e shpalljeve, duke u bazuar në këtë rregullore.
2. Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë pune, për bursa, dhe për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit.
3. Drejtoria e Arsimit është e obliguar t'i kryejë të gjitha punët administrative dhe teknike të domosdoshme dhe të nevojshme gjatë tërë procesit.

Neni 7

Aktivitet jashtëshkollore

Kompensimin e mjeteve për aktivitete jashtëshkollore bëhet në bazë të kërkesave të cilat dorëzohen në Drejtorinë e Arsimit përmes zyrës pritëse të administratës komunale.

Neni 8

Kushtet për ndarjen e bursave

1. Të drejtë konkurrimi për bursë komunale kanë të gjithë nxënësit dhe studentët, të cilët i plotësojnë këto kushte:

- 1.1 Të jenë banorë të Komunës së Obiliqit.
- 1.2 Të jenë të regjistruar si nxënës, përkatësisht studentë të rregullt, për herë të parë në vitin shkollor, gjegjësisht akademik, për të cilin ndahet bursa.

Neni 9

Kushtet dhe kriteret për të fituar bursë për studentë

1. Kushtet dhe kriteret për të fituar bursën për studentë janë:

1.1. Niveli i studimeve themelore (bachelor):

1.1.1 Të jenë studentë të regjistruar së paku në vitin e dytë të studimeve, përjashtim bëjnë, studentët me aftësi të kufizuara, studentët fëmijë të dëshmorëve, studentët jetim (me një prind ose pa asnjërin prind) dhe studentët familjet e të cilëve janë raste sociale të cilët përfitojnë bursë edhe për vitin e parë të studimeve, si student të rregullt.

1.1.2. Të kenë të regjistruar për herë të parë vitin (gjegjësisht semestrin e vitit) për të cilin ndahet bursa.

1.2. Niveli i studimeve master drejtimet:

1.2.1 Fakulteti i Shkencave Matematiko - Natyrore, Departamenti i Matematikës, Departamenti i Fizikës, Departamenti i Kimisë dhe Departamenti i Biologjisë përkatësisht drejtimi Ekologji dhe Mbrojtje të Mjedisit;

1.2.2 Fakulteti i Edukimit;

1.2.3 Fakulteti Teknik;

1.2.4 Specializimet në lëmin e mjekësisë;

1.2.5 Arkitekturë dhe Ndërtimtari;

1.2.6 Studentë të të gjitha drejtimeve të studimeve, për të cilët në bazë të mundësive buxhetore në pajtim me nenin 8 vendos komisioni për ndarjen e bursës,

1.2.7 Drejtimet nga pika 1 deri në pikën 5 të nenit 9 do të kenë prioritet në ndarjen e bursave.

1.3 . Niveli i doktoratës:

1.3.1 Nga të gjitha lëmit e studimeve me kusht që të ketë punime shkencore të publikuara në ndonjë revistë shkencore, (përfashtim bëhet për studentët të cilët janë në vitin e parë, duhet të dëshmojnë pagesën e semestrit të parë).

Neni 10

Kategorizimi e bursës

1. Kategorizimi i bursës do të shkallëzohet në 5 (pesë) kategori për:

1.1 Studentët fëmijë të dëshmorëve, viti i parë, kategori e parë.

1.2 Studentët e vitit të dytë, me notë mesatare deri në 7.99-të, kategori e parë.

1.3 Studentët e vitit të dytë, me notë mesatare, 8-të e më tepër, kategori e dytë.

1.4 Studentët e vitit të tretë, me notë mesatare deri në 7.99-të, kategori e dytë.

1.5 Studentët e vitit të tretë, me notë mesatare, 8-të e më tepër, kategori e tretë.

1.6 Studentët e vitit të katërt, me notë mesatare deri në 7.99-të, kategori e tretë.

1.7 Studentët e vitit të katërt, me notë mesatare, 8-të e më tepër, kategori e katërt.

1.8 Studentët e vitit të pestë, me notë mesatare deri në 7.99-të, kategori e katërt.

1.9 Studentët e vitit të pestë, me notë mesatare, 8-të e më tepër, kategori e pestë.

Neni 11

Bonuset

1. Studentët e këtyre kategorive fitojnë bonus shtesë, prej 0.5 (gjysmë pikë) më tepër, në aspektin e notës mesatare, notë mesatare që e përcakton kategorinë e studentit për bursë, sipas nenit 9 të kësaj Rregulloreje si:

1.1 Rastet sociale;

1.2 Studentët e veteranëve dhe invalidëve të luftës së UÇK-së;

1.3 Studentët, prindërit e të cilëve kanë qenë të burgosur politik;

1.4 Studentët nga komunitetet pakicë;

1.5 Studentët që nuk e kanë së paku njërin prind, apo nuk jetojnë më prindër dhe

1.6 Studentët në familjet e ngushta të të cilëve janë më shumë se dy studentë.

2. Studentët përfitues kanë të drejtë përfitimi vetëm në një kategori, nga gjithsej 6 kategori të pikës 1 të këtij neni.

3. Studentët e këtyre kategorive kanë bonus shtesë, një (1) pikë më tepër, në aspektin e notës mesatare, notë mesatare që e përcakton kategorinë e studentit për bursë, sipas nenit 10 të kësaj Rregulloreje si:

3.1 Studentët me nevoja të veçanta.

3.2 Studentët fëmijë të dëshmorëve.

Neni 12

Dëshmitë për rastet sociale

1. Gjendja ekonomike financiare e familjes (prindërve apo kujdestarit) të nxënësit apo studentit, vërtetohet sipas dëshmisë që e lëshon Qendra për Punë Sociale në Komunën e Obiliqit.

2. Komisioni për ndarjen e bursave rezervon të drejtën e hulumtimit dhe vërtetimit të gjendjes së vërtetë ekonomike-financiare të kandidatëve.

Neni 13

Ndarja e çmimit

1. Nga fondi i Kryetarit të Komunës (kategoria ekonomike – subvencion) ndahet bursa, në emër të çmimit “Adem Preniqi” për studentët më të dalluar të vitit përkatës.

2. Bursa ndahet me rastin e 28 Nëntorit Ditës së Flamurit (festë kombëtare shqiptare).

3. Çmimi (shuma) e bursës do të jetë dyfishi i bursës së kategorisë së parë sipas nenit 10 të kësaj rregullore.

Neni 14

Kushtet dhe kriteret për ndarjen e çmimit

1. Përfituesi i bursës për çmimin “Adem Preniqi”, do të zgjidhet nga kandidatët për bursë të rregullt, në bazë të këtyre kriterëve:

1.1 Të jetë student në vitin e fundit të studimeve.

1.2 Të mos ketë të përsëritur ndonjë vit gjatë studimeve.

1.3 Të ketë eliminuar, përkatësisht përfunduar vitin paraprak për të cilin ndahet bursa.

1.4 Të ketë notën mesatare, më të lartë gjatë studimeve (të të gjitha viteve paraprake) ndaj studentëve tjerë, por jo më pak se 9 (nëntë).

2. Bonusi (shtesa) në aspektin e notës mesatare, që është paraparë në nenin 11, të kësaj Rregulloreje, nuk vlen (nuk aplikohet), për çmimin “Adem Preniqi”.

3. Nëse nota mesatare e konkurrentit është e njëjtë, atëherë numri i provimeve të dhëna për vit të njëjtë të studimeve, do të merret në konsideratë si përparësi.

Neni 15

Ndarja e çmimit sipas kriterëve të njëjta

Në qoftë se disa studentë i kanë kriteret e njëjta, sipas nenit 14, atëherë studenti që ka më tepër provime të dhëna ka përparësi, në qoftë se edhe në këtë rast kriteret e plotësuar janë të njëjta atëherë, çmimi “Adem Preniqi” do të ndahet me short, i cili do të tërhiqet në praninë e studentëve që janë në garë për këtë çmim dhe anëtarëve të komisionit.

Neni 16

Ndarja e shpërblimeve

1. Komuna e Obiliqit varësisht prej mjeteve në dispozicion (planifikimeve buxhetore të Drejtorisë për Arsim) ndanë shpërblime për nxënës nga Komuna e Obiliqit, të cilët kanë arritur suksese në gara në nivel komune dhe në nivel nacional, për tri (3) vendet e para.
2. Komuna e Obiliqit varësisht prej mjeteve në dispozicion (planifikimeve buxhetore të Drejtorisë për Arsim) ndanë shpërblime për mesimdhënës apo udhëheqësin e ekipit garues të nxënësve, sipas lëndëve apo lëmive përkatëse, për të cilat nxënësit kanë treguar sukses duke fituar tri (3) vendet e para.
3. Shpërblimet ndahen pa përfunduar viti kalendarik përkatës, në të cilin janë mbajtur garat, përkatësisht janë arritur sukseset në tri (3) vendet e para.

Neni 17

Kriteret për ndarjen e shpërblimeve

1. Kërkesë me shkrim (e cila dorëzohet në Drejtorinë e Arsimit përmes zyrës pritëse të administratës së Komunës së Obiliqit)
2. Dokumenti i cili vërteton vendin e fituar në garat komunale ose nacionale.
3. Vërtetimi se në cilën shkollë i vijon mësimet nxënësi.

Neni 18

Bursat për nxënës

1. Kriteret për të fituar bursën për nxënës të shkollave të mesme të larta janë:

- 1.1 Të jenë nxënës të rregullt dhe të vijnë në mësimin rregullisht, në shkollat e mesme të larta të Komunës së Obiliqit;
- 1.2 Për nxënës të Gjymnazit "17 Shkurti", të kenë të përfunduar klasën paraprake të shkollës së mesme të lartë me sukses të shkëlqyeshëm (përfshihet klasa e X-të);
- 1.3 Për nxënës të SHMLP "Ismail Dumoshi", të kenë të përfunduar klasën paraprake, me sukses të shkëlqyeshëm (bursa ndahet edhe për klasën e X-të) dhe,
- 1.4 Për nxënës me nevoja të veçanta, fëmijë të dëshmorëve, nxënës familjet e të cilëve janë raste sociale, dhe nxënësit jetim (që nuk kanë asnjërin prind ose kanë vetëm njërin prind) të kenë të përfunduar klasën paraprake me suksese të shkëlqyeshëm (bursa ndahet edhe për klasën e X-të).

Neni 19

Kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit

1. Komuna e Obiliqit do të bëjë kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit në relacionin shtëpi - shkollë dhe anasjelltas, për nxënësit e Komunës së Obiliqit që mësimet i vijnë në shkollat e Komunës së Obiliqit, përjashtim bëjnë drejtimet e shkollës së mesme të larta në komunat tjera, të cilat nuk janë shkolla (drejtim) në Komunën e Obiliqit dhe nxënësit që për shkak të distancës më të afërt mësimet i vijnë në shkollat e komunave tjera, për këto kategori:

- 1.1 Nëse distanca e udhëtimit shtëpi - shkollë për nxënës, është së paku tri (3) kilometra;
- 1.2 Për nxënës me nevoja të veçanta dhe

- 1.3 Për nxënës, familjet e të cilëve janë raste sociale, (nëse në relacionet e udhëtimit të këtyre nxënësve, është i organizuar udhëtimi, publik apo privat).

Neni 20

Aktivitetet jashtëshkollore

1. Aktivitetet jashtëshkollore për nxënës:

- 1.1 Shëtitja një ditore për të gjitha nivelet, mbrëmja e semimaturës për nxënësit e klasave të IX-ta;
- 1.2 Ekskursioni për klasën e XII-të dhe mbrëmja e maturës për maturant.

2. Për aktivitetet e cekura në pikën 1 të këtij neni do të kompensohen, nxënësit që janë fëmijë të dëshmorëve, nxënësit jetim (që nuk kanë asnjërin prind ose kanë vetëm njërin prind) nxënësit me aftësi të kufizuara dhe nxënësit familjet (prindërit ose kujdestarët) e tyre që janë raste sociale.

Neni 21

Vlerësimi i kushteve dhe kriterëve

1. Pas skadimit të afatit për konkurrim, komisioni do të bëjë shqyrtimin e kërkesave, dhe do të hartojë listën përfundimtare të kandidatëve përfitues të bursës gjegjësisht përfitues të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit, gjithnjë duke u bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë Rregullore.

2. Listat e përfituesve të bursës, dhe përfituesve të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit, pas përfundimit përkatësisht miratimit do të shpallet publikisht, do të vendoset në tabelën e shpalljeve, dhe në ueb- faqen zyrtare të Komunës së Obiliqit.

Neni 22

E drejta e ankesës

1. Kundër vendimit të komisionit për ndarjen e bursave, kompensimit të udhëtimit, dhe aktiviteteve jashtëshkollore lejohet ankesë, në afat prej 5 ditë pune nga dita e shpalljes, përkatësisht publikimit të listës së përfituesve të bursës, gjegjësisht përfituesve të kompensimit të udhëtimit, ankesa i drejtohet komisionit për ankesa në Drejtorinë e Arimit përmes zyrës pritëse të administratës në Komunën e Obiliqit.

2. Komisioni për ankesa në një afat prej 5 ditë pune do të vendos dhe përgjigjet lidhur me ankesat e paraqitura brenda afatit të paraparë në pikën 1 të këtij neni.

Neni 23

Lidhja e kontratave

1. Me nxënës dhe studentë që e fitojnë bursën, dhe të drejtën e kompensimit të udhëtimit në relacionin shtëpi-shkollë lidhet kontratë.

2. Kontrata përpilohet nga Drejtoria e Arsimit, e cila nënshkruhet nga përfituesi i bursës dhe Kryetari i Komunës.

3. Me kontratë do të përcaktohet kohëzgjatja e dhënies së bursës dhe kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit.

Neni 24
Procedurat e pagesave

1. Nëse brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e njoftimit të kandidatit, përfituesi i bursës apo kompensimit të udhëtimit, nuk lajmërohet për marrjen e bursës përkatësisht të shpenzimeve të udhëtimit, kjo do të konsiderohet se kandidati ka hequr dorë nga bursa apo kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit.
2. Mjetet do të alokohen në xhirollogarinë e përfituesve të bursës, përfituesve të shpenzimeve të udhëtimit, apo përfituesve të aktiviteteve jashtëshkollore pranë ndonjë banke komerciale (në mungesë të xhirollogarive të nxënësve mjetet do alokohen në xhirollogari të prindërve apo kujdestarëve të nxënësve), ndërsa për fituesit e garave pagesa bëhet pa përfunduar viti kalendarik fiskal.
3. Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, dhe Drejtoria e Arsimit janë të obliguara që të përkujdesen për alokimin e mjeteve të përfituara për bursë në afatin sa më të shkurtër.

DISPOZITAT KALIMTARE - PËRFUNDIMTARE

Neni 25
Zbatimi i Rregullores

Zbatimin e kësaj Rregulloreje nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës e bëjnë: Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim.

Neni 26
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për Ndarjen e Bursave, Shpenzimeve të Udhëtimit dhe Aktiviteteve Jashtëshkollore në Komunën e Obiliqit me nr.-I-149 e datës 30/08/2019.

Neni 27
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen e Komunës së Obiliqit.

KUVENDI I KOMUNËS SË OBILIQIT

Nr. 1-104 Datë 31.08. 2020

Kryesuesi i Kuvendit
Burim Gërguri



Xerox® WorkCentre® 7845

Workflow Scanning Confirmation Report



Job Details:

Job Status:

0 out of 1 filed successfully.

Job Information

Device Name: XRX9C934E670069
Submission Date: 23/02/24
Submission Time: 11:25

Template Information

Name: SCANTO.XST
Owner: WCP_SCAN_TO
Description: ---

File Settings

Format: Image-Only PDF
Multi-Page
Images Filed: 0
Bytes Filed: 0

Scan Settings

Images Scanned: 8
Original Type: Photo and Text
How Produced: Printed Original
Original Orientation: Portrait Originals
Original Size: Auto Detect
Background Suppression: Off
Lighten/Darken: Normal
Contrast: Normal
Sharpness: Normal
Saturation: Normal
Sides Imaged: 1-Sided
Resolution: 200 dpi
Bits per Pixel: 24
Output Color: Auto Detect
Quality/File Size: Higher/Larger
Compression: MRC_ZLAYER_MULTI

Destination 1:

Status Details:

Status:..... FAILED

Login failure. Check user password, and/or setups.

Friendly Name:

Fatime

Server Name:

10.153.123.142:445

Path:

Fatime.Pilana

Protocol:

SMB

Filing Policy:

Add Number

Document Name:

Destination 2:

Status Details:

Status:.....

Friendly Name:

Server Name:

Path:

Protocol:

Filing Policy:

Document Name:

Destination 3:

Status Details:

Status:.....

Friendly Name:

Server Name:

Path:

Protocol:

Filing Policy:

Document Name:

Destination 4:

Status Details:

Status:.....

Friendly Name:

Server Name:

Path:

Protocol:

Filing Policy:

Document Name:

Destination 5:

Status Details:

Status:.....

Friendly Name:

Server Name:

Path:

Protocol:

Filing Policy:

Document Name:

Destination 6:

Status Details:

Status:.....

Friendly Name:

Server Name:

Path:

Protocol:

Filing Policy:

Document Name: